

## BASHKIA LEZHË

## PROJEKT-VENDIM

Nr. 2194 Datë 18.03.2019**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6% PËR VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të kreut IV, pika 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe Udhëzimit nr. 5 dt. 17.02.2017,

**PROPOZOJMË:**

Të miratohen kriteret për përdorimin e kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6 % si më poshtë ;

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit, nepërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2, të vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.
3. Dokumentacioni dhe masa e përfitimit llogaritet sipas strukturës së familjes mbështetur në Udhëzimin nr. 4 dt. 17.02.2017 “ Për përlllogaritjen e përfitimit të Ndhmës Ekonomike” .

**KRYETARI**

Fran FRROKAJ

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

ZV/KRYETAR

Enver HAFIZI

